



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
K r y e t a r i

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 01/11, lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive në Komunën e Vushtrrisë, Kryetari i Komunës me datën 08.04.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Obligohen nëpunësit civil në administratën e komunës që me rastin e ofrimit të shërbimeve komunale ndaj palëve të jenë të pajisur me maska mbrojtëse dhe dorëza.
2. Obligohen bizneset e komunës që t'i pajisin punëtorët e tyre me maska dhe dorëza. Inspektorati i komunës do ti mbyllë dhe shqiptoj gjoba konform legjislacionit në fuqi, të gjitha bizneseve në të cilat gjen se punëtorët e tyre janë të pa mbrojtur me pajisje personale(maska dhe dorëza).
3. Obligohen marketet në komunën e Vushtrrisë që të bëjnë dezinfektimin e karrocave të gjitha llojeve pas çdo përdorimi (të caktoj punëtorin që do të merret me këtë punë).
4. Asnjë biznes nuk do të i ofroj shërbim (shitje të mallit) asnjë konsumatori i cili hyn në lokalini e biznesit pa maskë dhe dorëza. Në raste të tillë Inspektorati i komunës do të mbyllë dhe shqiptoj gjoba konform legjislacionit në fuqi çdo biznesi në të cilin gjenden konsumatorë që janë të pa mbrojtur me pajisje personale mbrojtëse (maska dhe dorëza). Po ashtu gjoba do të iu shqiptohen konform rregullativës ligjore edhe konsumatorëve që hyjnë pa mjete mbrojtëse personale (maska dhe dorëza).
5. Apelojmë tek të gjithë qytetarët që të rrinë në shtëpi, ta ruajnë distancën kudo, ndërsa kur do të kenë nevojë për të dalë jashtë shtëpisë, të bartin maska dhe dorëza.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Inspektimet
- Arkivit të Sekretarisë



Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës